

VENDIM
Nr. 577, datë 11.10.2023

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 610, DATË 7.7.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN E FONDEVE PËR
VEPRIMTARI SPECIFIKE OPERATIVE TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS
DHE SIGURISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 610, datë 7.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin dhe kontrollin e fondeve për veprimtari specifike operative të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2 shtohen fjalët “..., duke përjashtuar kontributet e vendeve dhe agjencie anëtare të NATO-s.”.

b) Në pikën 3, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:
“ë) veprimtari specifike në kuadër të bashkëpunimit me vendet e NATO-s.”.

c) Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Për qëllime, sipas shkronjës ‘ë’, të pikës 3, të këtij vendimi, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes mund t’i kërkojë ministrit përgjegjës për financat të hapë një llogari speciale në një bankë të nivelit të dytë, që operon në sistemin bankar të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të projekteve të përbashkëta në fushën e sigurisë kombëtare dhe luftës kundër terrorizmit.

Ky fond specifik do të përdoret vetëm me dakordësi të kontribuesit.”.

2. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama